

Buletini i Lajmeve të Sigurisë Kibernetike

Janar 2023

INVESTIME KONKRETE NË SIGURINË KIBERNETIKE – PRIORITET I SHQIPËRISË DHE PARTNERËVE STRATEGJIKË

Autoriteti Kombëtar për CESK në bashkëpunim me Departamentin Amerikan të Shtetit dhe MITRE Corporation organizoi seminarin 3-ditor “Senior Policymaker Cyber Strategy Planning”. Qëllimi i seminarit 3- ditor është finalizimi i zhvillimit të kornizave të një Strategjie Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, e cila përfshin hartimin e qëllimeve të politikës, identifikimin e iniciativave mbështetëse për secilin qëllim, identifikimin e aktorëve për secilën iniciativë dhe rekomandimet për sfidat dhe tejkalimin e tyre për implementimin e aktiviteteve.



Gjate këtyre 3 ditëve Drejtori i përgjithshëm i AKCESK prezantoi vizionin e ri strategjik të Autoritetit, i cili mbështetet në 5 shtylla kryesore, si dhe shprehu angazhimin e institucioneve shqiptare për bashkërendim dhe bashkëpunim në krijimin e një mjedisi kibernetik të sigurt. Në këtë kuadër, drejtori i përgjithshëm i Autoritetit evidentoi gjithashtu nevojën për bashkëpunim me partnerët strategjikë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për forcimin e qëndrueshmërisë kibernetike në vend.

Seminari 3-ditor u fokusua ne rolin e secilit institucion të sigurisë dhe të mbrojtjes në hartimin e strategjive të sigurisë dhe politikave për menaxhimin e çështjeve të sigurisë kibernetike, si edhe harmonizimin e planeve strategjike me praktikën më të mira të US .

Në përfundim të seminarit, Drejtori i Përgjithshëm i AKCESK, njëkohësisht Koordinator Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, falenderoi për mbështjen Departamentin Amerikan të Shtetit dhe MITRE Corporation për suportin dhe ekspertizën e vyer.



<https://cesk.gov.al/2023/Investim%20strategjik%2024.01.2023.pdf>

KONTAKT

Rr. "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë Albania 04-22-21039

FOKUSI I VIZITËS SË DELEGACIONIT SHQIPTAR NË IZRAEL - SHKËMBIMI I PRAKTIKAVE MË TË MIRA TË SIGURISË KIBERNETIKE

Gjatë vizitës së tij në Izrael, drejtori i Përgjithshëm i AKCESK Z. Igli Tafa, së bashku me përfaqësues të infrastrukturave kritike të sektorit bankar, zhvilluan një takim me përfaqësues të Njësisë së Mbrojtjes Kibernetike të Banking Supervision Department, për shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira në fushën e sigurisë kibernetike.

Gjatë takimit, drejtori i përgjithshëm i AKCESK theksoi prioritetin e autoritetit për rritjen e qëndrueshmërisë kibernetike në sektorin bankar, si dhe nevojën për ngritje kapacitetesh.



28 JANARI, DITA E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

28 Janari e cila ndryshe në botë njihet edhe si Dita e Privatësisë – Privacy Day , ka si qëllim kryesor njohjen, ndërgjegjësimin dhe promovimin në tërësi të të drejtave dhe lirive themelore të individit . Një shoqëri demokratike e shëndetshme nuk mund të kuptohet pa një proces të vazhdueshëm edukativ për kultivimin e kulturës në ushtrimin praktik të këtyre të drejtave. Në këtë kontekst, e sidomos duke marrë në konsideratë përparimin teknologjik dhe digjitalizimin, mbrojtja e të dhënave personale është shumë e rëndësishme dhe në themel të zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë.



Email: info@cesk.gov.al Web:

www.cesk.gov.al